



Datë/Data/Date:	22.12.2025
Nga/Od/From:	z. Halil Thaçi – Kryetar i Komunës së Obiliqit
Për/Za/To:	z. Sami Ahmeti – Kryesues i Kuvendit Komunal të Obiliqit
Tema/Subjekat/Subject	Kërkesë

I nderuar kryesues i Kuvendit Komunal z. Sami Ahmeti,

Ju drejtohem me kërkesë, në cilësinë tuaj si kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit, që në mbledhjen e radhës së Kuvendit, para asamblistëve të paraqitni për miratim paraprak Propozim-Vendimin e Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për vitin 2026, si dhe Listën e Përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës.

Komisioni komunal bazuar në 13 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e dt.03.04.2019, nën 6 të Rregullores (QRK.) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2026, andaj komisioni ka hartuar listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2025 si dhe listën e përgjithshme.

Pronat e Paluajtshme siç është cekur edhe në Propozim Vendim respektivisht në listën e veçantë të përgatitura nga Komisioni komunal planifikohen të jepën në shfrytëzim afatgjatë prej 15-99 vite.

Destinimi i këtyre pronave do të jete për zhvillimin e veprimtarive biznesore përmes së cilave synohet krijimi i vendeve të reja të punës për qytetaret e komunës së Obiliqit si dhe rritja e vlerës ekonomike për këto prona. Të drejte aplikimi për manjën e këtyre pronave në shfrytëzim në kushte të barabarta sipas legjislacionit në fuqi do të kenë të gjithë personat fizik dhe juridik siç është e rregulluar me nenin 7 paragrafi 1,2 dhe 3 të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2026.

Me respekt!